



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:095798  
Datë: 17.01.2024  
Numri i dokumentit: 05203742

**C - IV – 23 – 0094**

**Paditësi:**

S H nga fshati B i Komunës së Mitrovicës, e të cilin me autorizim e përfaqëson, av. B I nga Prishtina.

**Kundër**

**E paditura:**

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lagjja, "Lakrishtë", Prishtinë.

**Për :** Palët ndërgjyqëse.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, me **dt.17.01.2024**, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. PRANOHET pjesërisht si e bazuar** kërkesëpadia e paditësit, S H nga fshati B i Komunës së Mitrovicës e ushtruar kundër të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë – Autoriteti Likuidimit (AL) dhe Vendimit, PRN032-0176 të dt.31.05.2013 të Autoritetit të Likuidimit (AL) të të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë dhe Vendimi, PRN032-0176 të dt.31.05.2013 i Autoritetit të Likuidimit (AL), **NDRYSHOHET pjesërisht dhe OBLIGOHET**, e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) - Autoriteti i Likuidimit (AL) me seli në Prishtinë, që paditësit, në emër të tre pagave të papaguara, t'ia kompensoj shumën prej **3,677.07 € (tre mijë e gjashtë qind e shtatëdhjetë e shtatë euro e shtatë centë)**, dhe kumatën ligjore prej 10 % në shumën prej **367,70 € (tre qind e gjashtë dhjetë e shtatë euro e shtatë dhejtë centë)** nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), "Magjistranja" me seli në Prishtinë (në likuidim) e nga totali i kërkuar prej 3,724.56 € derisa Vendimi, PRN032-0176 i dt.31.05.2013 i Autoritetit të Likuidimit (AL) për pjesën e pranuar të kërkesës së paditësit, në procedurën e likuidimit në shumën prej 47.49 € në procedurën e likuidimit, **VËRTETOHET pjesërisht si drejtë dhe i bazuar në ligj** derisa shuma e pranuar e kërkesëpadiës, duhet të përmbushet në pajtim me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

**II. REFUZOHET pjesërisht si e pabazuar** kërkesëpadia e paditësit, S H nga fshati B i Komunës së Mitrovicës e ushtruar kundër të paditurës, Agjencia Kosovare e

Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë për pjesën lidhur me normën e kamatës së bazuar në ligj – kamatë vonesë në shkallën prej 3,5% (neni 277 i LMD-së të RSFJ) e cila në shumën e borxhit kryesor prej 3,724.56 €, që rrjedh prej dt. 01.01.2008 (prej kur kreditorit është dashur t'i paguhet paga përkatsisht kur detyrimi i debitorit, është bërë i përmbarueshëm) e deri me datën 19.12.2012 (kur ka hyrë në fuqi Ligji i Detyrimeve i Kosovës), në shumën prej 651.80 €, dhe për periudhën prej dt.19.12.2012, duke filluar prej hyrjes në fuqi të Ligjit të LMD-së e që nga kjo kohë me kamatën prej 8 % ( neni 382.2 i LMD-së) në shumën e tërësishme prej 819.40 € dhe shumën tjetër të kamatës në të njëjtën lartësi e deri në pagesën e plotë, në shumën e tërësishme të kamatës deri më dt.21.09.2015, shumën prej 1,471.20 €.

**III. PRANOHET pjesërisht si e bazuar** kërkesa e paditësit, S H nga fshati B i Komunës së Mitrovicës për caktimin e me shpenzimet procedurale në këtë çështje juridike kontestimore, CAKTOHEN pjesërisht shpenzimet procedurale dhe atë në emër të hartimit të padisë në shumën prej 104.00 €, në emër të ankesës së ushtruar ndaj aktgjykimit të shkallës së parë, shumën prej 208.00 €, në emër të shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore për padi, në shumën prej 20.00 € si dhe në emër të shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore për padi, në shumën prej 20.00 € e në shumën e përgjithshme prej **352,00 € (tre qind e pesë dhjetë)**, si dhe **OBLIGOHET**, e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) që paditësit, t'ia kompensoj shpenzimet e pranuar procedurale në këtë çështje juridike kontestimore.

**IV. REFUZOHET pjesërisht si e pabazuar** kërkesa e paditësit, S H nga fshati B i Komunës së Mitrovicës e ushtruar kundër të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë për caktimin e shpenzimet procedurale dhe atë : në emër të të kërkesës ndaj Autoritetit të Likuidimit (AL), në shumën prej 52.00 €, dhe në emër të shqyrtimit të shkresave të lëndës, në shumën prej 52.00 € dhe në emër të shpenzimeve për kundërshtimin e mbrojtjes së AKP-së, në shumën prej 104.00 € .

### **Rrethanat Faktike dhe Procedurale**

Me 10 korrik 2013, pranë DhPGJSK-së, është parashtruar padia e paditësit se bashku me grupin e punëtorëve prej 142 si padi grupore kundër të paditurës, Ndërmarrjes Shoqërore (NSH), "Magjistranja" me seli në Prishtinë (në likuidim) në lidhje me Vendimin e Autoritetit Likuidimit (AL), PRN032-0176 të dt.31.05.2013 për NSH, "Magjistranja" me seli në Prishtinë (në likuidim), me të cilin i është pranuar një pjesë e kërkesës në shumën prej 47,49 € derisa për pjesën tjetër të kërkesës së tij për dëmshpërblim për pagat e pa paguara në shumën prej 3,677.07 € e nga totali i saj i kërkuar si dëmshpërblim për pagat e pa paguara në shumën prej 3,724.56.00 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSH), "Magjistranja" me seli në Prishtinë dhe se kjo lëndë ka pasur shenjën, C – IV – 13 – 1216 por për shkak të Urdhrit të kësaj gjykate, C - IV. – 13 – 1216 të dt.27.11.2013 për ndarje të saj, kjo lëndë ka marrë shenjën, C – IV – 15 – 1772 .

Në arsyetimin e këtij Vendimi, AL-ja, është bazuar në atë se Autoriteti i Likuidimit (AL), se pasi ka konstatuar se informacionet dhe provat e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës, kanë rezultuar si të pa mjaftueshme për shqyrtimin e saj, AL-ja, ia ka dërguar paditësit, një letër e përmes së cilës, paditësit, i ka kërkuar justifikim të vlefshëm si dhe informacione shtesë dhe dëshmi, e më pas letra në fjalë, pasi që është pranuar rregullisht nga paditësi, i njëjti me dt.07 Maj 2013, pranë AL-së, ka dorëzuar një kopje të listës së pagave që pretendon se nuk i janë paguar për periudhën Janar 2006 – Dhjetor 2007 të nënshkruar nga llogaritari dhe drejtori i NSH, "Magjistranja" (NSH), se AL-ja, për të kryer se verifikime të mëtejshme në lidhje me kërkesën, në përputhje me neni 18 të Ligjit të AKP-së, me dt.22 Maj 2013, ka kërkuar informacione nga Banka Ekonomike mbi historiatin e llogarisë së klientit (NSH Magjistranja) për periudhën Janar 2006 deri më Dhjetor 2007, dhe se me dt.23 maj 2013, kjo bankë e ka dorëzuar në AKP, përgjigjjen bashkë me historikun e llogarisë së klientit për periudhën e kërkuar, nga e cila rezulton se paditësi, ka

punuar orë efektive pune në NSh deri në muajin mars 2006 dhe është paguara për këto muaj deri në masën 80 % të pagës së tij NETO, se nuk ka asnjë provë përpara AL-së se paditësi, pra z. H ka vazhduar të punonte për NSh, "Magjistrala" si dhe se paditësi, nuk figuruar në listën e pagave të ndërmarrjes për muajt e tjerë të pretenduar nga kërkuesi, këtu paditësi dhe se rrjedhimisht kërkesa e z. H, konsiderohet e përmbushur një herë në masën 80 % të saj për muajt Janar – Mars 2006 në përputhje me nenin 37 par.9.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr,04/034 të AKP-së, i cili parasheh se : "Përveç bazave të tjera të kundërshtim të kërkesës, Autoriteti i Likuidimit, gjithashtu ka të drejtë pa kufizime që – të kundërshtoj një kërkesë tërësisht ose pjesërisht bazuar në faktin se kërkesa është përmbushur në mënyra të tjera ...", se AL-ja, kërkesën e paditësit e ka konsideruar si pjesërisht të vlefshme dhe si rrjedhojë e ka aprovuar shumën prej 47.49 € (20 % e shumës së pagës) e kjo shumë përbën vlerën neto të pagueshme ndaj kërkuesit pasi që pjesa e tatimit mbi të ardhurat personale dhe kontributi pensional janë mbajtur në momentin e pagesës së vlerës së 80% të rrogës.

Më tutje në arsyetimin e Vendimit të kontestuar (kundërshtuar) të Autoriteti i Likuidimit (AL), thuhet se në se pajtueshmëri me nenin 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Autoriteti i Likuidimit, ka ardhur në përfundimin se pjesa tjetër e kërkesës së paraqitur nga parashtuesi – paditësi, mbeti e pa provuar plotësisht pas kërkesë për dokumente shtesë, prandaj edhe vendosi që paditësit, t'ia refuzoj kërkesën e tij, se AL-ja, nuk është në gjendje që të vlerësoj përqindjen e shpërndarjes, se çdo shpërndarjes e autorizuar e Bordit të AKP-së, duhet t. bëhet përmes transferimit bankar e më gjerësisht si në arsyetimin e këtij Vendimi të kundërshtuar të AL-së.

Pala paditëse parashtesën e ka titulluar si "*parashtesë*", mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtesave me të cilat bëhet "*nisja e procedurave*" pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa .

Padisë – ankesë së tij si prova, paditësi, ia ka bashkëgjetur: kopjen e librezës së punës dhe Vendimin, PRN032-0176 të dt.31.05.2013 të Autoritetit të Likuidimit si dhe pjesë e dosjes së lëndës, janë edhe shënimi zyrtar i dt.03.06.2021 për lëndën, C – IV. – 13 – 1216, si dhe autorizimi i dhënë nga paditësi për av.B Inga Prishtina, kopja e librezës së punës së paditësi, dhe kontaktën e punës.

Me dt.11.04.2014, e paditura, AKP-ja, në lëndën, C – IV. – 13 – 1216, duke vepruar sipas Urdhrit të kësaj gjykate, C – IV. – 13 – 1216 të dt.27.02.2014, ka paraqitur mbrojtjen e saj ndaj ankesës së parashtuesve të dorëzuar me dt.10 korrik kundër Vendimeve respektive të AL-së të paraqitura nga ish punëtorët e NSh,"Magjistranja" me seli në Prishtinë e duke filluar që nga Vendimi, PRN032 – 0136 e deri te Vendimi i AL-së, PRN 032 – 0176, e në të cilën në ndër të tjerash, ka theksuar se NSh "Magjistranja" ka hyrë në procedurën e likuidimit me datën 13.04.2007, pala paditëse pranë Autoritetit të Likuidimit me datën 12.07.2007, ka paraqitur një kërkesë përmes të cilës ka kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara e duke e parë që kërkesa e parashtuesit ka qene jo e qartë dhe në mungesë të dëshmiave te cilat do të tregonin se NSh-ja i ka mbetur në borxh, Autoriteti i Likuidimit, paditësit, i ka dërguar parashtesë me të cilën ka kërkuar informata dhe dëshmi shtesë. Tutje ka cekur se ankesa e paditësit, është e pa pranueshme sepse nuk e ka respektuar nenin 24.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L- 033 për AKP-në (ish Ligi),e i cili parasheh se : "*Secili parashtues dhe palë kundërshtare përfaqësohet nga një anëtarë i shoqatës apo odës së avokatëve*", se asnjë kopje e autorizimit nuk është përfshirë në shkresat e lëndës, të cilat iu dërguan palës kundërshtare nga zyra e regjistrimit, se ka cituar nenin 25.8 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L- 033 për AKP-në, që flet për mënyrën e paraqitjes së shkresave në gjykatë, se paditësi, nuk ka treguar se cili nen i Ligjit, Nr.04/L – 033, është shkëlur nga AL-ja, se paditësi, nuk ka paraqitur ankesë të pranueshme dhe për këtë arsye ankesat e tyre duhet të hudhen si të pa

pranueshme në bazë të neneve 28.3 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L- 033 për AKP-në, se e paditura, si palë kundërshtare mendon se 75 parashtrues, është fakt thelbësor se nuk kanë ofruar shërbime të punës për NSh-në gjatë periudhës së kërkuar, se ata nuk kanë kryer ndonjë punë në emër të NSh-së për të cilin kishin mundur që të kërkojnë pagat në mënyrë të arsyeshme, e kjo situatë është konfirmuar nga menaxhmenti i NSh-së, nëpërmjet listë pagesave për muajt Janar 2006 – Prill 2007, të nënshkruara rregullisht nga menaxhmenti i NSh-së dhe sipas ekstraktit bankar të Bankës Ekonomike, se këta punonjës të cilët kanë punuar për NSh-në, në të vërtetë janë paguar nga NSh-ja, se parashtruesit të cilët nuk kanë ofruar shërbime pune për NSh-në dhe nuk janë paguar për periudhën Janar 2006 – Dhjetor 2006, se një konfirmim i listave të punëtorëve të cilët punuan dhe u paguan nga NSh-ja gjatë Janar 2006 – Dhjetor 2006, iu paraqit palës kundërshtare, këtu të paditurës nga Banka Ekonomike (bashkëlidhur), e 75 parashtruesit nuk janë pjesë e asaj liste, se e paditura, i mbahet qëndrimin se e drejtës për të paguar është e drejtë ekskluzive e atyre punëtorëve që *de facto* kanë ofruar shërbime të punës për NSh-në, e për këtë arsye, e paditura, ka kërkuar nga parashtruesi (përmes Kërkesës për informata Plotësuese), çdo provë që parashtruesi, këtu paditësi, në të vërtetë kanë ofruar shërbime të punës për NSh-në, se parashtruesit nuk kanë siguruar provat dhe rrjedhimisht kërkesat e tyre, janë refuzuar mbi bazat e nenit 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 se :’’ ... *Dokumentacioni për Kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar apo bartësi i interesit të pretenduar mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës nga kreditori i pretenduar për dokumente apo dëshmi plotësuese*’’, se për më tepër 67 punonjës, kanë punuar dhe kanë marrë 80 % të shumës së rrogës së tyre mujore prej NSh-së, se AL-ja, ka pranuar 20 % të shumës së rrogës së tyre mujore në vendimet e lëshuara nga parashtruesit, se këto gjetje u mbështetën në llogaritë bankare të Bankës Ekonomike, prandaj AL-ja, pjesërisht i ka pranuar kërkesat e tyre, se në lidhje me pjesën që AL-ja, ka refuzuar kërkesën ka ndodhur në pajtim me nenin 37 par.9.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në, ku parasheh se: ’’*AL-ja ka të drejtë që të kundërshtoj një kërkesë, tërësisht apo pjesërisht, bazuar në faktin që kërkesa është përmbushur në mënyra tjera*’’, se pala kundërshtare, këtu e paditura, ka vërejtur në ankesë se pretenduar gabimisht që disa punonjësve iu janë pranuar pjesërisht kërkesat kur në fakt kërkesat e tyre janë refuzuar, e me emrat e listuar në këtë mbrojtje, prej F S e deri tek Xh B. B, dhe në përfundim, i ka propozuar gjykatës që t’ia refuzoj si të pa pranueshme dhe/ose të pa bazuar dhe të vërtetohet (lihet në fuqi) Vendimi i Autoritetit të Likuidimit në përputhje në zbatim të nenit 70.4 te Ligjit, nr.04/L-033 e më gjerësisht si në këtë mbrojtje.

Me dt.30.09.2015, paditësi, përmes të të autorizuarit të tij, duke vepruar sipas Urdhrave të kësaj gjykate, C – IV – 13 – 1216 të dt.27.11.2013, dhe C – IV – 13 – 1216 të dt.26.02.2014, ka bërë plotësimin dhe rregullimin e padisë e në të cilën ka theksuar se paditësi, është njëri nga 142 paditësit e padisë së përbashkët me numër të rastit si më sipër dhe duke e përkrahur plotësisht atë po ia dorëzon DhPGJSK-së, padinë individuale të paditësit tani të plotësuar dhe rregulluar, se paditësi, kishte kërkuar prej AL-së, pagat e pa paguara për periudhën Janar 2006 deri më Dhjetor 2006 (12 paga e jo 24 sish) në shumën prej 3,677.07 € por e cila kërkesë është e refuzuar si e ’’pa pranueshme’’, dhe se me Vendimin e tij, PRN032 – 0176 i dt.31.05.2013, AL-ja, ia kishte refuzuar kërkesën e tij dhe atë për : shkak të vërtetimit të gabuar të rrethanave faktike në NSh ’’Magjistrallja’’ dhe 2) për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave juridike, se si vërtetimi të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ka cekur atë se e paditura, me rastin e vendosjes së kërkesës, nuk e ka kontestuar faktin se paditësi ishte në marrëdhënie të rregullt dhe të përhershme të punës në këtë NSh, e kjo sigurisht se ekziston dokuemtacion i mjaftueshëm (letër pezullimi, librezë e punës dhe Lista e 20 %-shit) e cila dëshmon se paditësi ishte në marrëdhënie të punës te e paditura si dhe NSh-ja, ishte e obliguar që t’ia paguaj të gjitha pagat e pa paguara deri në ditën e privatizimit të NSh-së ashtu edhe siç premtuhej edhe me dokumentin e Njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Paditësi më tej, në këtë parashtrësë, ka shtuar se Vendimi i Autoritetit të Likuidimit, referohet pa ndonjë arsye në dispozitën e nenit 18 të Ligjit për AKP-në, i cili flet për përgjegjësit e AKP-së, se Autoriteti i Likuidimit ka bërë ndarjen e punëtorëve aktiv dhe jo aktiv por nuk ka dhënë asnjë bazë juridike se cila dispozitë e ligjit e bënë ndarjen e punëtorëve aktiv dhe jo aktiv ndërsa në vazhdim të vendimit të saj thuhet se Autoriteti i Likuidimit, i paska kërkuar Bankës Ekonomike në Prishtinë, më dt.22.05.2013 informata për historikun e llogarisë së paditësit për muajt Janar 2006 deri në muajin Dhjetor 2007, e duke e kundërshtuar Vendimin e AL-së sepse nuk është banka e as Banka Ekonomike që i lëshon apo ruan – mban listat e pagave , se pikërisht nga Lista e pagave shihet se paditësit, i ka mbetur borxh NSh-ja e kjo dëshmohej nga kjo listë e pagave mujore duke filluar nga muaji Janar 20065 e deri në më Dhjetor 2007, se nga lista e pagave të ndërmarrjes dhe nga listat e hartuara nga kontabilisti i ndërmarrjes vërehet se për periudhën kontestuese parashtruesi i ankesës radhitet me numër 09 ndërsa në rubrikat tjera të listave janë të dhënë detaje të tjera për orët e punës dhe pagën mujore Janar 2006 e më tutje dhe në shumën neto të 24 pagave shuma prej 3,724,56 €, ka cekur çështjen se në bazë të Ligjit të Punës , punëdhënësi është i obliguar që rregullisht të bëjë pagesën e pagave mujore të punëtorëve e në rastin e Magjistralsë, punëdhënësi nuk ka marrë kurrfarë vendimesh tjera përpos atij që ishte në fuqi për pagesën e rregullt të pagave, se në padinë fillestare të përbashkët, ka paraqitur provat gjegjëse duke filluar nga prokura e deri te kopja e listës së pagave, në bazë të gjendjes së fakteve , i ka propozuar gjykatës që këtë pa seancë t’ a miratoj në shumën prej 3,724.56b me kamatë prej 10 % ose nëse këto prova janë të pa mjaftueshme për gjykatën, ka kërkuar që të hap seancën dhe të ttërras për dëgjim, punëtorin, dëshmitarët, drejtorin, Sh P, dhe kontabilistë e NSh-së, ‘’Magjistrala’’, A K, G H dhe A B, se e ka kundërshtuar pretendimin – komentin e fundit të AL-së në vendimin e tij kur ka referuar në nenin 36 par.2. 2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.03/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP).

Tutje paditësi, si zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ka cekur faktin se është shkelur neni 36 par.2.2 i AKP-së lidhur me kërkesat pa vlefshme dhe jo të rregullta se sipas provave dhe dokumentacionit për pagat sipas legjislacionit në fuqi (Ligji për Ndërmarrjet e RSFJ-së i vitit 1989 – 1990, Ligji i Punës i KSAK të Kosovës, Rregullorja e UNMIK-ut për Ligjin e Punës, Nr.2001/27, Ligjit mbi Trustin Pensioneve të Kosovës dhe Ligjit mbi Tatimin në Paga), është i detyruar t’i mbaj punëdhënësi, pra e paditura, dhe i ka propozuar gjykatës, që duke pasur për bazë Ligjin Ndërkombëtar të Punës dhe parimin ‘’Pro Labore’’ të mbroj të drejtat e punëtorëve duke vepruar sipas kërkesë për sigurimin e provave (neni 379, 380, 381, 382, 383, 384 dhe 385 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, Nr.03/L- 006) dhe t’ a detyroj të paditurën, që të paraqes në gjykatë tërë dokumentacionin e plotë (lista e pagave, evidencën e punëtorëve, kopjet e librave, si dhe dokumentacionit tjetër relevant për këtë çështje). Me qëllim që gjykata të mund të vërtetoj plotësisht gjendjen faktike në këtë çështje juridike dhe të mund të jap drejtësinë e kërkuar nga paditësi, se këtë dokumentacion të marrëdhënies së punës, sipas ligjeve në fuqi, është detyruar t’i mbaj dhe ruaj punëdhënësi – e paditura, se po ashtu ankuesi konteston kundërshtimin e AL-së, duke cituar praktikën gjyqësore të Kolegjit të Apelit të kësaj gjykate lidhur me rastin, AC – I - 14-0323 - A0001 dt.12.03.2005, ku konstaton se letër pezullimi i lëshuar nga AKM/AKP, është njohje e detyrimeve ndaj kreditorëve pra edhe detyrimi i pagesës së pagave të papaguara, në pretendimet e mëtejme të tij lidhur me bazën juridike të kërkesës i autorizuari i paditësit, ka cituar dispozita nga Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), nenin 382 të LMD-së, për kamatë vonesën, nenin 383 të LMD-së për lartësinë e kamatës si dhe nenin 384 të LMD-së për të drejtën e paditësit në kamatëvones si dhe i ka kërkuar shpenzimet procedurale dhe i ka specifikuar ato në shumën gjegjës e sipas dispozitave ligjore nga neni 449 i LPK-së numrave gjegjës tarifor sipas Odës së Avokatëve të Kosovës e përfundimisht i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të lëndës ta miratoj si të bazuar kërkesëpadinë dhe me aktgjykim te anulohet vendimi i të paditurës, PRN032-0176 i dt.31.05.2013, dhe te detyrohen AKP-ja dhe Autoriteti i Likuidimit i NSh, Magjistrallja’’ me seli

në Prishtinë (në likuidim) që në emër të pagave të pa paguara, t'ia kompensojnë shumën e borxhit kryesor prej 3,724,56 €, e me kamatën e bazuar në ligj – kamatë vonesë në shkallën prej 3,5% (neni 277 i LMD-së të RSFJ) e me normën e kamatës së bazuar në ligj – kamatë vonesë në shkallën prej 3,5% (neni 277 i LMD-së të RSFJ) e cila në shumën e borxhit kryesor prej 3,724.56 €, që rrjedh prej dt. 01.01.2008 (prej kur kreditorit është dashur t'i paguhet paga përkatsisht kur detyrimi i debitorit, është bërë i përmbarueshëm) e deri me datën 19.12.2012 (kur ka hyrë në fuqi Ligji i Detyrimeve i Kosovës), në shumën prej 651.80 €, dhe për periudhën prej dt.19.12.2012, duke filluar prej hyrjes në fuqi të Ligjit të LMD-së e që nga kjo kohë me kamatën prej 8 % ( neni 382.2 i LMD-së) në shumën e tërësishme prej 819.40 € dhe shumën tjetër të kamatës në të njëjtën lartësi e deri në pagesën e plotë, në shumën e tërësishme të kamatës deri më dt.21.09.2015, shumën prej 1,471.20 € si dhe i ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale të përfaqësimit në naze të Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës për hartimin e padisë në vlerë prej 104.00 euro si dhe të gjitha shpenzimet tjera deri në fund të procedurës.

Me dt.27 Prill 2021, DhPGJSK-ja, me Urdhrin e saj, C – IV. – 15 – 772 të dt.27 Prill 2021, parashtrësën e dt.30.09.2015, ia ka dërguar të paditurës për të dhënë përgjigje.

Me dt.19.05.2023, e paditura, AKP-ja me seli në Prishtinë përmes përfaqësuesit të saj, në këtë gjykatë, ka parashtruar kundërpërgjigjen e saj e në të cilën, është bazuar në çështjen e se kujt i takon barra e të provuarit sipas nenit 7 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe nenit 31 të Ligjit, nr.06/L – 086, se parashtruesi jo vetëm se nuk ka paraqitur ndonjë argument të ri por mbi të gjitha ka bashkëlidhur të njëjta dokumente si në ankesë e më gjerësisht si në këtë Përgjigje dhe se kësaj Përgjigje ia ka bashkangjitur provat gjegjëse që kanë qenë pjesë e lëndës, C – IV. - 15 – 1772 dhe se pjesë e kësaj lënde, është edhe Shënimi zyrtar për lëndën, C – IV. – 13 – 1216, kopja e prokurës për përfaqësim të paditësit nga avokati gjegjës, kopja e ID-së së paditësit, kopja e Vendimit të AL-së, PRN032 – 0176 të dt.31.05.2013, kopja e librezës së punës së paditësit, dhe kopja e kontratës së punës së paditësit e lidhur në mes tij dhe SHA, ”Magjistrala”, Prishtinë.

Me dt.10.11.2021, DhPGJSK-ja mbi bazën e pretendimeve të elaboruara më lartë, me aktgjykimin e saj, C – IV- 15 – 1772 të dt.10.11.2021, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit e më gjerësisht si në këtë aktgjykim dhe se pas ushtrimit të ankesës nga paditësi ( i ka bashkangjitur provat gjegjëse: kopja e librezës së punës së paditësit, kopjen e kontratës së punës së dt.01.12.2005 të lidhur në mes tij, dhe SH.A “Magjistranja”, Prishtinë, kopjen e listës së emrave përpçagat prej muajit Janar deri në muajin Dhjtor 2006 të punëtorëve të SH.A “Magjistranja”, Prishtinë, kopjen e shkresës së dt.16.07.2007 e ish Drejtori të SH.A, ”Magjistranja”, Prishtinë për prezentimin e listës së punëtorëve tek AKM-ja – Zyra Regjionale e AKM-së në Prishtinë, kopjen e deklaratës nën betim të noterizuar të Sh P, Drejtor, dhe A K llogaritar, së bashku me ID-të e tyre, kopjen e kontratës së punës së dt.01.12.2005 të lidhur në mes Sh P, dhe SH.A “Magjistranja”, Prishtinë, kopje e aktvendimit, Nr.1088 i dt.21.06.2007 i Drejtorit të SH.A “Magjistranja”, Prishtinë për ndërprerjen e marrdhënies së punës për punëtorin e saj, S H, dhe kopja e referencës së dt.25.05.2007 e dhënë nga përgjegjësi në SH.A “Magjistranja”, Prishtinë për drejtorin, Sh P) kundër këtij aktgjykimi Kolegji i Apelit i DhPGJSK-së, me aktvendimin e tij, AC – I. – 21 – 0819 – A0001 të dt.13 Prill 2023, ankesën e paditësit e ka pranuar si të bazuar, ka anuluar aktgjykimin e kësaj gjykate, C – IV - 15 – 1772 të dt.10.11.2021, lëndën e ka dërguar për rigjykim në shkallën e parë të DhPGJSK-së, si dhe ka vedosur se nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedurë ankimore dhe se pas kthimit në ri vendosje kjo lëndë, ka marr numri, C – IV. – 23 - 0094.

Me dt.07.11.2023, DhPGJSK-ja, në procedurën ri vendosjes, me Urdhrin e saj, C – IV. – 23 – 0094 të dt.07.11.2023, ka urdhëruar të paditurën, që në afatin prej 3 (tre) ditëve pas ditës së pranimit të këtij urdhri, pranë kësaj gjykate, duhet të parashtrëj/dorëzoj, sqarim lidhur me qëndrimin e shprehur nga Autoriteti i Likuidimit (AL) në Vendimin e tij, PRN032 – 0176 të

dt.31.05.2013 për NSh, "Magjistranja" me seli në Prishtinë e duke i siguruar provat e reja lidhur me kërkesën paditësit për dëmshpërblim për paga të pa paguara, e me arsyetimin se paditësi a është paguar 80 % nga NSh-ja, si dhe se ka qenë kontestuese se Lista e pagave, nuk e qartëson se a janë ekzekutuar apo janë borxh pagat që NSh-ja në fjalë, iu ka mbetur ish punëtorëve të saj, pra e paditura, AKP-ja me seli në Prishtinë, duhet të deklarohej lidhur me çështjen e pagesës apo jo të 80 % të pagave si dhe a janë ekzekutuar apo janë borxh pagat që NSh-ja në fjalë si dhe mund të paraqes edhe prova tjera që eventualisht e paditura, AKP-ja me seli në Prishtinë, i konsideron të nevojshme në procedurën e rivendosjes për këtë çështje juridike kontestimore.

Me dt.07.11.2023, e paditura, AKP-ja, duke vepruar sipas këtij Urdhri, ka paraqitur Përgjigjen gjegjëse e në të cilën, është bazuar në çështjen e se kujt i takon barra e të provuarit sipas nenit 7 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe nenit 31 të Ligjit, nr.06/L – 086, se ka cekura AL-ja, ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike në bazë të nenit 36 par.2 të Shtojcë së Ligjit, Nr.04/L-034 si dhe ka dhënë sqarim se duke vepruar në përputhje me nenin 18 të Ligjit të AKP-së, me dt.23 Maj 2013, ka kërkuar informacione nga Banka Ekonomike mbi historiatin e llogarisë së klientit (NSH Magjistranja) për periudhën Janar 2006 deri më Dhjetor 2007, dhe se me dt.23 maj 2013, kjo bankë e ka dorëzuar në AKP, përgjigjen bashkë me historikun e llogarisë së klientit mirëpo ka rezultuar se paditësi, ka punuar orë efektive pune në NSh, se deri në muajin Mars 2006 dhe është paguara për këto muaj deri në masën 80 % të pagës së tij NETO, dhe se kjo shihet qartë me aktgjykimin e dt.10.11.2021 që gjykata e shkallës së parë, e ka refuzuar ankesën e paditësit dhe e ka vërtetuar vendimin e AL-sëd he se kësaj Përgjigje ia ka bashkangjitur provat gjegjëse pjesë e lëndës, C – IV. - 15 – 1772 e duke filluar nga Formiëari i plotësuar dhe i dërguar tek AKP-ja për pagat e pa paguara e deri te Ndalesat e dt.16.07.2007 që ju janë bërë punëtorëve të SHA, "Magjistranja" nga të ardhurat personale për Trust Pensional të deklaruara të pa paguara e më gjerësisht si në këtë Përgjigje.

Me dt.07.11.2023, DhPGJSK-ja, në procedurën ri vendosjes, me Urdhrin e saj, C – IV. – 23 – 0094 të dt.07.11.2023, ka urdhëruar paditësin, S H nga B i Komunës së Mitrovicës, që në afatin prej 7 (shtatë) ditëve pas ditë së pranimit të këtij urdhri, që të bëjë plotësimin e padisë së tij të dt.30.09.2014 të parashtruar pranë DhPGJSK-së, dhe atë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL), PRN032 – 0176 të dt.31.05.2013 për NSh, "Magjistranja" me seli në Prishtinë e duke i siguruar provat e reja e në mbështetje të kërkesës së tij e veçmas duke Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës – përfundimin e punësimit në NSh, "Magjistranja" me seli në Prishtinë e më gjerësisht si në këtë Urdhër.

Me dt.15.11.2023, duke vepruar sipas këtij urdhri, paditësi, është përgjigjur me Përgjigjen e tij e të cilës ia ka bashkangjitur provat gjegjëse e duke filluar prej Letër pezullimit të dt.22 Maj 2007 për përfundimin e punësimit tek NSh-ja në fjalë e deri te Regjistri i punëtorëve dhe të dhënat e tyre gjatë punës në NSh e në të cilën Përgjigje në mes tjerash e ka kundërshtuar pretendimin e të paditurës se ai nuk ka qenë në listën e pagave si dhe nuk ka kryer shërbime për periudhën Janar 2006 - prill 2007 por edhe e ka kundërshtuar edhe qëndrimin e AKP-s që është bazuar në nenin 37 par.9.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, se e paditura nuk e ka kundërshtuar faktin se paditësi ka qenë në marrëdhënie të rregullt dhe të përhershme të punës tek kjo NSh dhe duke u bazuar në Letër pezullimin e dt.22 Maj 2007 për përfundimin e punësimit tek NSh-ja në fjalë, kjo NSh, ishte e obliguar që atij t'ia paguante atij të gjitha pagat e pa paguara deri në ditën e privatizimit, se AL-ja e kishte kontestuar ekzistimin e listës së pagave të NSh-së për periudhën e pa përcaktuar për të cilën është ky dëmshpërblim nga arsye se AL-ja, vendoste kërkesat e kreditorëve pa i njoftuar fare me gjendjen e detyrimeve të NSh-së ndaj kreditorëve ndërsa punëtori nuk dispononte me arkivin e Ndërmarrjes shoqërore dhe po ashtu punëtorët, besonin se AL-ja, e ka në dispozicion arkivin e dokumenteve, se në bazë të provave gjegjëse, listës së pagave të hartuara nga kontabiliteti i Njësisë së "Magjistrales" tek Drejtoria dhe të nënshkruara nga personat e autorizuar për periudhën Janar Dhjetor tor 2006 të kërkuara në padi, shihet qartë

se paditësi, është radhitur me numrin 26 dhe pagën mujore, e ka pasur në shumën prej 376,64 €, bruto, se përmes deklaratave të noterizuara nën betim të Sh P, Drejtor i kësaj NSH-je dhe A K llogaritar i kësaj NSH-je, provohet pretendimi i paditësit se NSH-ja i ka mbetur borxh, se AL-ja, nuk e ka sqaruar se pse në Vendimin e tij, është thirr në nenin 37 par.9.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së kur ka thënë se kërkesa është përmbushur në mënyra tjera e duke aluduar në pretendimin e të paditurës se paditësit, i është përmbushur - paguar për periudhën e pretenduar nga ana e tij për muajin Janar 2006 në masën 80 % të pagë së tij NETO derisa për muajt gjegjës të vitit 2006, paga i është dhënë plotësisht, se e paditura, nuk e ka sqaruar afatin e kontestuar të parashtrimit të padisë në mënyrë të plotë dhe bindëse, si dhe se paditësi, është bazuar në praktikën gjyqësore të Kolegjit të Apelit të DhPGJSK-së e duke filluar nga lënda, AC – I – 15 – 0274 e deri te lënda, AC – I – 21 – 0827 për rastet e ngjashme kur paditësve tjerë për këto paga të pa paguara, ua ka pranuar kërkesëpaditë e tyre e duke u bazuar në Letër pezullimin, deklarata në betim, Listën e pagave etj, si dhe i ka propozuar gjykatës që duke u bazuar në nenin 11 dhe 63 pika 1 dhe 3 të Ligjit, Nr.06/L – 086 për Dhomën së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me nenin 4449 të pika 1 dhe të 2 të Ligjit, Nr.03/L – 006 mbi Procedurën Kontestimore i ka kërkuar gjykatës që me aktvendim të pranoj shpenzimet e procedurës dhe atë shpenzimet e përfaqësimit në bazë të nenit 7 të Rregullores për Tarifat e Avokatëve të OAK-së të dt.18.03.2017 dhe atë për kërkesën ndaj Autoritetit të Likuidimit (AL), në shumën prej 52.00 € sipas nr.tarifor 16, për shqyrtimin e shkresave të lëndës, në shumën prej 52.00 €, sipas numrit tarifor 15 pika 1, për hartimin e padisë në shumën prej 104.00 €, për kundërshtimin e mbrojtjes së AKP-së në shumën prej 104.00 €, sipas numrit tarifor 6, si dhe në emër të shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në shumën prej 30.00 € e në shumën e përgjithshme prej 332.00 € e duke i propozuar DhPGJSK-së që t'a miratoj në tërësi si të bazuar padinë e tij dhe t'a anuloj vendimin e të paditurës e më gjerësisht si në këtë Përgjigje dhe se kësaj përgjigje ia ka bashkangjitur të gjitha provat e bashkangjitura, lëndës, C – IV. – 15 – 1772 dhe ankesës së ushtruar kundër aktgjykimit të DhPGJSK-së, C – IV - 15 – 1772 të dt.10.11.2021 e duke filluar nga kopja e librezës së punës së paditësi, kontata e punës, e veçmas Lista e emrave të punëtorëve të SHA, "Magjistrat", Prishtinë.

## Arsyetimi Ligjor

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i ka përmbajtur padia si dhe pas sigurimit të provave gjegjëse pas kthimit në ri gjykim të çështjes, nuk e vërtetojnë faktin se duhet të caktohet seancë dëgjimore dhe se për këtë arsye, gjykata ka marrë aktgjykim, pa caktuar seancës dëgjimore si dhe pa u bërë dëgjimi i palëve në procedurë si dhe dëgjimi i dëshmitarëve gjegjës .

Po ashtu në nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), parashihet se: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”* derisa sipas nenit 7 par. 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se : *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Pas shqyrtimit të provave të lëndës parashtrimeve dhe pretendimeve të palëve në procedurë, si dhe duke vepruar sipas vërejtjeve të bëra nga Kolegji i Apelit i DhPGJSK-së në aktvendimin e saj, AC – I – 21 – 0189 të dt.13 Prill 2023, gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e



paditësit, S H nga fshati B i Komunës së Mitrovicës, është pjesërisht e bazuar për një pjesë të saj kurse pjesërisht, është e pabazuar mbi pjesën e kërkesëpadisë së paditësit për kamatën, si kërkesë aksesore.

### ***Pranueshmëria dhe afatshmëria e kërkesës së paditësit.***

Gjykata, ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqës, dhe ka konstatuar se NSh, "Magjistranja" me seli në Prishtinë (likuidim), me dt.13.04.2007, ka hyrë në procedurën e likuidimit derisa me njoftimin e dt.25 Maj 2005 e lëshuar nga AKP-ja, paditësit, i është përfunduar punësimi me dt.22 Maj 2007 dhe me këtë rast i ka njoftuar punëtorët për ndërprerjen e kontratave të punës, përfshirë edhe paditësin derisa pala paditëse pranë Autoritetit të Likuidimit (AL), me dt.06 Gusht 2014, pra brenda afatit ligjor, ka parashtruar kërkesë për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 3,724.56 € për periudhën duke filluar nga muaji Janar e deri në muajin Dhjetor Dhjetor 2006 nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), "Magjistranja" me seli në Prishtinë (në likuidim) dhe se Autoriteti i Likuidimit pasi që ka bërë vlerësimin e kërkesës së parashtruar nga paditësi, me Vendimin e tij, PRN032-0176 të dt.31.05.2013, kërkesën në fjalë të paditësit, ia ka pranuar pjesërisht për një pjesë të saj kurse pjesërisht ia ka refuzuar si të pavlefshme pjesën tjetër të saj derisa paditësi, pas pranimi të këtij aktvendimi në procedurën e likuidimit, pas dt.04.06.2013, padinë kundër Vendimit të AL-së, PRN032-0176 të dt.31.05.2013, pranë DhGJSK-së, në mënyrë grupore edhe me paditësit tjerë, si ish punëtor të NSh, "Magjistranja" me seli në Prishtinë (në likuidim), me dt.03 korrik 2013, e ka paraqitur brenda afatit ligjor prej 30 ditëve pas pranimi të tij në lëndën, C – IV. – 13 - 1216, dhe se padisë/ankesës së tij, paditësi, ia ka bashkangjitur një kopje të Vendimit të Autoriteti të Likuidimit, PRN032-0176 të dt.31.05.2013 për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), "Magjistranja" me seli në Prishtinë (në likuidim) e ndaj të cilit është ngritur kundërshtimi.

Gjykata, pra me gjendjen e tillë të shkresave të lëndës, ka vlerësuar se padia/ankesa/ kërkesë e paditësit, i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe afatshmërisë nga dispozitat e nenit 36, dhe 74 të Ligjit Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) lidhur me nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP).

### ***Faktet jo kontestuese dhe kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.***

Gjykata gjen se nuk është kontestuese se në mes të palëve ndërgjyqëse, ka qëndruar raporti juridik i marrëdhënies së punës në mes të paditësit dhe NSh, "Magjistranja" me seli në Prishtinë (në likuidim) e të cilën tani e përfaqëson AKP-ja si dhe me shkresën e dt.25.2.2007 të lëshuar nga ish AKM-ja (AKP), të gjithë të punësuarve pranë kësaj NSh-je, përfshirë edhe paditësin, nga dt.25.11.2005, i është përfunduar punësimi tek kjo NSh por kontestuese mbetet çështja e bazës juridike e kërkesës së paditësit e të cilën e paditura, ka konsideruar si të pavlefshme për një pjesë të saj, e për të cilën pjesë të kërkesës së paditësit, e paditura, ka konsideruar se për periudhën e caktuar nuk ka ofruar shërbime për ndërmarrjen dhe se nuk ka qenë në listën e punëtorëve aktiv të ndërmarrjes, ndërsa në Vendimin e AL-së, PRN032-0176 të dt.31.05.2013, të kundërshtuar, kërkesa e tij, i është refuzuar në arsyetimin se :“informacionet dhe provat që ka dorëzuar parashtruesi i kërkesës kanë rezultuar të pavlefshme ...” dhe se në plotësim të kërkesës ka dorëzuar një kopje të listës së pagave që pretendon se nuk janë paguar për periudhën e pretenduar, pra se paditësi, a ka të drejtë që të kërkojë nga e paditura, Ndërmarrja Shoqërore, (NSH), "Magjistranja" me seli në Prishtinë (në likuidim), kompensimin në emër të

dëmshpërblimit për pagat e pa paguara përpos shumës së pranuar prej 47,49 €, të kërkojë edhe pjesën e kërkesës së refuzuar në shumën e prej 3,677.07 € e nga shuma totale e tyre prej

3,724,56 € e më gjerësisht me përshkrimin e dhënë si në Vendimin e AL-së, PRN032-0176 të dt.31.05.2013.

Në nenin 6 të Ligjit Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), që flet për fushëveprimin e kompetencave administrative të Agjencisë, aty thuhet se : *''Agjencia ka kompetenca të gjëra dhe ekskluzive administrative mbi të gjitha ndërmarrjet, asetet, interesat, aksionet dhe pronën që bie në fushëveprimin e nenit 5.1 dhe 5.2. ....''* .

Në rastin konkret, gjykata ka konstatuar se kërkesa e paditësit, ka të bëjë me kërkesat e pa siguruara për pagat e të parapara në nenin 40 par.1 pika 1.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në e në të cilin, parashihet se : *''Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: ... kërkesat e pa siguruara, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë''* .

Gjykata ka shqyrtuar pretendimet dhe provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqëse si dhe respektimit të qëndrimeve të Kolegjit të Apeli të kësaj gjykate të dhëna në aktvendimine tij, AC – I – 21 – 0189 të dt.13 Prill 2023, kur kjo gjykatë si gjykatë e shkallës së parë, ka kërkuar plotësimin e padisë së paditësit me provat gjegjëse si dhe kur nga e paditura, është kërkuar që të jap sqarime gjegjëse lidhur me pretendimin e saj se paditësi është paguar 80 % të rrogës nga NSh-ja, si dhe pretendimin se është kontestuese se Lista e pagave, nuk e qartëson se a janë ekzekutuar apo janë borxh pagat që NSh-ja në fjalë, iu ka mbetur ish punëtorëve të saj, pra e paditura, AKP-ja me seli në Prishtinë, është dashur të deklarohet lidhur me çështjen e pagesës apo jo të 80 % të pagave si dhe a janë ekzekutuar apo janë borxh pagat që NSh-ja në fjalë dhe se pas sigurimit të provave gjegjëse në procedurën e rivendosjes, është konstatuar se emri i llogaritarit të NSh-së si dhe emri i drejtorit të NSh-së që e kanë nënshkruar, listën e pagave për Muajt Janar – Dhjetor 2006, sipas deklaratave të noterituar të tyre nën betim, si prova dhe pjesë e shkresave të lëndës, janë A K, llogaritar dhe Sh P, drejtor i NSh-së si dhe se në bazë të Letër Pezullimit të dt.22 Maj 2007 si dhe Listës së pagave për periudhën Janar 2006 deri në muajin Dhjetor 2006, është provuar se paditësit, me dt.22 Maj 2007, i është përfunduar punësimi tek NSh-ja në fjalë si dhe në listave e pagave, është renditur nën numrin 26 dhe se paga mujore e tij, tek kjo NSh, ka qenë 376,64 € derisa sipas librezës së punës, paditësit, ajo i është mbyllur me dt.13.4.2007.

Gjykata, e mori si të drejtë qëndrimin e shprehur në Vendimin e kundërshtuar të AL-së, kur e ka pranuar një pjesë të kërkesës së paditësit në procedurën e likuidimit dhe atë në shumën prej 47,49 € por se tani nuk mund të marrë si të drejtë dhe të plotë qëndrimin juridik të paditurës me rastin e refuzimit së të pa vlefshme të pjesës së kërkesës së parashtruesit në shumën prej 3,677.07 € në emër të dëmshpërblimit për pagat e pa paguara pasi që AL-ja, gabimisht ka zbatuar dispozitën materiale nga neni 37 par.9.2 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në kur ka thënë se kërkesa është përmbushur në mënyra tjera e duke aluduar në pretendimin e të paditurës se paditësit, i është përmbushur - paguar për periudhën e pretenduar nga ana e tij për muajin deri në muajin Mars 2006 në masën 80 % të pagë së tij NETO si dhe, kur AL-ja, vije në përfundim se kërkesa e parashtruesit, mbeti e pa provuar plotësisht pas kërkesës për dokumente plotësuese sipas vendimit të AL-së, andaj të njëjtin vendim gjykata e ndryshoj pjesërisht për detyrimin kryesor në të holla edhe për shumën e refuzuar të kërkesës së paditësit, si dhe duke pranuar pjesërisht kërkesën e paditësit derisa e ka refuzuar pjesërisht si të pa bazuar pjesën e kërkesë padisë së tij që ka të bëjë me kumatën ligjore dhe kumatë vonesë si kërkesa aksesore.

Gjykata gjen se sipas Letër Pezullimit të dt.22 Maj 2007, është provuar se paditësit, me dt.22 Maj 2007, i është përfunduar punësimi tek NSh-ja në fjalë si dhe sipas Listës së pagave për periudhën Janar 2006 deri në muajin Dhjetor 2006, është renditur në numrin 26 dhe se paga

mujore e tij, tek kjo NSh, ka qenë 376,64 € (mirëpo paditësi në formularin e plotësuar, e ka cekur shumën e pagës mujore prej 310.38 € e për 12 paga e në shumën e krkuar prej 3,724.56 €) dhe se sipas Deklaratave nën betim, këto lista i ka nënshkruar, Sh P, drejtor i NSh-së, dhe A K, inkasant – llogaritar i NSh-së, pra konstatohet se paditësi kishte qenë në marrëdhënie pune tek SH.A, “Magjistranja” me seli në Prishtinë deri në pranimin e njoftimit të dt. 22 maj 2007, të lëshuar nga AKM, me të cilën e njofton paditësin se marrëdhënia e punës së tij përfundon menjëherë dhe se kërkesat për paga të paguara do të shqyrtohet në procedurë të likuidimi, nga regjistri përmbledhja mujore e rrogave të punëtorëve për periudhën kohore të pretenduar të llogaritura dhe të miratuar nga drejtori i NSh, “Magjistranja” me seli në Prishtinë (në likuidim), evidenton pagën mujore prej 376.64 euro, gjykata konsideron si të drejtë pranimin e kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin në emër të dëmshpërblimit për pagat e pa paguara (12 sish e jo 24 sish siç e ka cekur në parashtresën e dt.30.09.2015) për pjesën refuzuar të tyre në shumën prej 3,677.07 €, dhe se ky qëndrim i kësaj gjykate bazohet në dispozitat nga neni 40.1.7 i Ligjit nr.04/L-034 për AKP që në mënyrë taksative citon se : *“Kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person”* dhe se këto kërkesa dhe interesa të kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 nga i njëjti nen 40 të këtij Ligji.

Për çështjen e pagesës së pagave për të një punësuari në një ndërmarrje në nenin 14 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2001/27 i dt.8 tetor 2001 për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës), ka qenë e paraparë se : *“Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës”* kurse në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit), parashihet se : *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ...”* kurse nenin 67 të Ligjit të Punës, Nr. 03/ L-212 të dt.1 nëntor 2010, që flet për Ndërprerjen e Kontratës së Punës sipas fuqisë ligjore, aty thuhet se : *“Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet: ... 1.8. me falimentimin dhe likuidimin e ndërmarrjes”* ndërsa në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit), parashihet se : *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ...”* .

Derisa kjo gjykatë lidhur me pjesën e kërkesëpadisë së paditësit për kamatën ligjore prej 10 % në shumën prej 367,70 € për detyrimin kryesor në të holla në shumën prej 3,677.07 €, vlerësoj se në rastin konkret, duhet të zbatohet dispozita e nenit 37 par.3 i Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në e në të cilën thuhet se: *“Të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kushte që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore”*. Ndërsa kjo gjykatë duke u bazuar në dispozitat e cituara më lartë, pjesërisht ia refuzoj kërkesëpadinë e paditësit lidhur me pjesën tjetër të saj lidhur me normën e kamatës së bazuar në ligj – kamatë vonesë në shkallën prej 3,5% (neni 277 i LMD-së të RSFJ) e cila në shumën e borxhit kryesor prej 3,724.56 €, që rrjedh prej dt. 01.01.2008 (prej kur kreditorit është dashur t’i paguhet paga përkatsisht kur detyrimi i debitorit, është bërë i përmbarueshëm) e deri me datën 19.12.2012 (kur ka hyrë në fuqi Ligji i Detyrimeve i Kosovës), në shumën prej 651.80 €, dhe për periudhën prej dt.19.12.2012, duke filluar prej hyrjes në fuqi të Ligjit të LMD-së e që nga kjo kohë me kamatën prej 8 % (neni 382.2 i LMD-së) në shumën e tërësishme prej 819.40 € dhe shumën tjetër të kamatës në të njëjtën lartësi e deri në pagesën e plotë, në shumën e tërësishme të kamatës deri më dt.21.09.2015, shumën prej 1,471.20 € sepse dispozitat e nenit 37 par.3 të Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në, kanë efekt superior, përfshirë edhe për kërkesat për kamatë vonesën, si kërkesa aksesore të parapara me Ligjin e Marrëdhëniet e Detyrimeve, pra në 37 par.1 të Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në, përcaktohet se : *“Dispozitat e këtij neni kanë efekt superior mbi dispozitat e*

*mundshme kontradiktore të kontratave, zgjidhjeve, marrëveshjeve, aktgjykimeve apo rregullimeve tjera të lidhura nga Ndërmarrja apo në emër të saj''*. Andaj gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko – civile, kërkesëpadinë/ankesën e paditësit të ushtruar kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL), PRN032-0176 të dt.31.05.2013 për kompensimin në emër të dëmshtëpërblimit për pagat e pa paguara për pjesën e refuzuar të kërkesës për këto paga në shumën prej 3,677,07 € e si dhe kamatës ligjore prej 10 % në shumën prej 367,70.€ nga NSh, “Magjistranja” me seli në Prishtinë (në likuidim), nga shuma totale e kërkuar prej 3,724.56 €, duhet t’ a pranoj pjesërisht si të pazuar për një pjesës së kërkesëpadisë së tij derisa Vendimin e Autoritetit të Likuidimit (AL), PRN032-0176 të dt.31.05.2013, për pjesën e pranuar të kërkesës në shumën prej 47,49 €, duhet t’ a vërtetoj pjesërisht si të drejtë dhe të bazuar në ligj kurse për pjesën e kërkesëpadisë së paditësit për kamatën ligjore mbi shumën e pranuar si dhe për kamatë vonësën, si kërkesa aksesore, këtë pjesë të kërkesëpadisë së paditësi, duhet t’ a refuzoj pjesërisht si të pabazuar.

### ***Vlerësimet përfundimtare të çështjes nga ana e gjykatës.***

Gjykata pas shqyrtimit të të gjitha provave të cilat gjendjen në shkresat e lëndës, ka vlerësuar se nuk qëndron pretendimi i të paditurës, AKP-së të se kërkesa e paditësit, është e pavlefshme si dhe se kjo kërkesë, nuk ka pasur prova të mjaftueshme nga neni 36 par.2.1 të Shtojcës së Ligjit të, Nr.04/L – 034 për AKP-në , si dhe se kërkesa, është përmbushur në mënyra të tjera e kuptim të nenit 37 par. 3 të Shtojcës së Ligjit të, Nr.04/L – 034 për AKP-në, kur në vendimin e kundërshtuar të AL-së, PRN032-0176 të dt.31.05.2013, pra ka thënë se kërkesa është përmbushur në mënyra tjera e duke aluduar në pretendimin e të paditurës se paditësit, i është përmbushur - paguar për periudhën pretenduar nga ana e tij për muajin Mars 2006 në masën 80 % të pagë së tij NETO si dhe, kur AL-ja, vije në përfundim se kërkesa e parashtruesit, mbeti e pa provuar plotësisht pas kërkesës për dokumente plotësuese sipas vendimit të AL-së, pra se paditësi, ka punuar orë efektive pune në NSh deri në muajin mars 2006 dhe është paguara për këto muaj deri në masën 80 % të pagës së tij NETO, se nuk ka asnjë provë përpara AL-së se paditësi, pra z. H, ka vazhduar të punonte për NSh, ”Magjistranja” si dhe se paditësi, nuk figuruar në listën e pagave të ndërmarrjes për muajt e tjerë të pretenduar nga kërkuesi, këtu paditësi dhe se rrjedhimisht kërkesa e z. H, konsiderohet e përmbushur një herë në masën 80 % të saj për muajt Janar – Mars 2006 në përputhje me nenin 37 par.9.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr,04/034 të AKP-së dhe se e paditura duke mos e provuar për pagesën e kryer deri në muajin Mars 2006 në masën 80 % të pagë së tij NETO si dhe pas sigurimit të provave gjegjëse, është konstatuar se emri i llogaritarit të NSh-së si dhe emri i drejtorit të NSh-së, që ka qenë e nënshkruar, sipas deklaratave të noterizuar të tyre nën betim, si prova dhe pjesë e shkresave të lëndës, nga A K, llogaritar dhe Sh P, drejtor i NSh-së kurse në bazë të Letër Pezullimit të dt.22 Maj 2007 si dhe Listës së pagave për periudhën Janar deri në muajin Dhjetor 2006, është provuar se paditësit, me dt.22 Maj 2007, i është përfunduar punësimi tek NSh-ja në fjalë si dhe në listave e pagave, është renditur në numrin 26 dhe se paga mujore e tij bruto, tek kjo NSh, ka qenë, 376.64 € ( e kërkuar nga paditësi në shumën neto prej 310,38 € dhe për 12 paga mujore, 12 x 310.38 € = 3,724.56 €), e nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se paditësi, kishte ofruar shërbime punë për NSh-në dhe se NSh-ja, i kishte mbetur borxh pagat e pa paguara për periudhën e lartcekur dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për pagat e papaguara, në shumën e pranuar të saj. Andaj gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontestimore, kërkesëpadia e paditësit, S H nga fshati B i Komunës së Mitrovicës e ushtruar

kundër të paditurës, AKP-së me seli në Prishtinë lidhur me Vendimin, PRN032-0176 të dt.31.05.2013 të Autoritetit të Likuidimit (AL) për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), “Magjistranja” me seli në Prishtinë (në likuidim), është pjesërisht e bazuar, dhe se i njëjti Vendim i AL-së, duhet të ndryshohet si dhe të detyrohet e paditura, AKP-ja me seli në Prishtinë, që paditësit, t’ia

kompensoj pagat e pa paguara në shumën prej 3,677.07 € e mekamatën ligjore prej 10 % në shumën prej 367,70 € derisa Vendim i AL-së, për pjesën e pranuar të kërkesës prej 47.49 € në procedurën e likuidimit, duhet që pjesërisht të vërtetohet si drejtë dhe i bazuar në ligj kurse për pjesa e kërkesëpadisë së paditësit lidhur me kamatën e bazuar në ligj - kamatë vonesën në shkallën prej 3.5 % si dhe prej 8 %, si kërkesa akcesore për borxhin kryesor, duhet të refuzohet pjesërisht si e pabazuar.

Përfundimisht gjykata ka konstatuar se në rastin konkret pala kundërshtare pjesërisht drejtë ka vepruar kur ka zbatuar dispozitën ligjore të cituara me lartë dhe bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) lidhur me nenin 153, 159, 160, 190, 197 dhe nenit 199 të Ligjit, Nr.03/L 066 për Procedurën Kontestimore (LPK) .

### **Shpenzimet Gjyqësore**

Në bazë të nenit 11, 62 par. të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), dhe nenit 13 par.3 dhe 13 par.9 të Udhëzimit administrativ, Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të KGJK-së, dhe lidhur me nenin 449 dhe nenin 463 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjykata vendosi që t'a pranoj pjesërisht si të bazuar kërkesa e palës paditëse për caktimin e tyre derisa një pjesë të shpenzimeve gjyqësore, e refuzoj pjesërisht si të pa bazuar në ligj kurse pala e paditur, duhet t'i bart shpenzimet gjyqësore sepse në bazë të nenin 62 par.2 të Ligjit nr.06/L-086 të DhPGJSK-së dhe nenit 452 të LPK-së, është përcaktuar se vetëm palës së suksesshme në procedurë (palës që e fiton gjykimin), i takon kompensimi i shpenzimeve gjyqësore dhe se paditësi, është i përfaqësuar nga avokati e në këtë proces gjyqësor, pala paditëse, e ka fituar pjesërisht këtë proces gjyqësor, andaj gjykata ka vendosur që pala e paditur si palë në procedurë, t'i bart shpenzimet gjyqësore në këtë çështje juridike kontestimore e më gjerësisht, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS** **2023:095798, 17.01.2024**

**Gjykatësi**  
**Agron Hoxhaj**

### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi nga pala e pa kënaqur mund të parashtrohet ankesë me shkrim duke iu drejtuar Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe atë brenda afatit prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditëve** e duke llogaritur pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPSGJSK).